

V E N D I M
Nr. 184, datë 21.4.2000

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PUNËS, “PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
QENDROR PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 8388, datë 5.8.1998, “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullore së punës “Për funksionimin e komisionit qendror për grumbullimin e armëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ngarkohet ministri i Rendit Publik, ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Pushtetit Lokal dhe komisioni qendror për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta